

VENDIM
Nr. 191, datë 13.7.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DOMA GROUP” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/8 prot., datë 10.7.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Doma Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Doma Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1721/4 prot., datë 18.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1721/3 prot., datë 18.6.2026 dhe *email*-in e datës 9.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721/5 prot., datë 29.6.2026 dhe *email*-in e datës 9.7.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se ka nevojë të plotësohet dokumentacioni për mbështetjen financiare sipas vlerës së investimit që rezulton nga kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e mbështetjes financiare brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Doma Group” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti